



Rrjetet për Sukses

Një prej çelsave kryesorë për suksesin në ndryshimin e mjedisit të shkollës është aftësia për zhvillimin dhe përsosjen e rrjeteve ndërvepruese. Prindërit, nxënësit, mësuesit, personeli mbështetës dhe administratorët, nuk jetojnë dhe punojnë në vakum – ka njerëz përrreth të cilët na mbështetin dhe përfitojnë prej nesh. Ne mund të mbështetemi në njohuritë dhe mjeshtritë e njeri-tjetrit, të mësojmë se si ata i përcjellin situatat e ngjashme, ose se si i realizojnë qëllimet e tyre, ne mund të ndajmë me ta burimet, të kërkojmë dhe japim ndihmë dhe kurajë në sfidat e ndryshme. Rrjetet mbështetëse na ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë të jetës dhe zgjerimin e kufijve tanë profesionalë dhe individualë, duke na mundësuar të arrijmë rezultate, të cilat do të ishin të pamundura nëse do të vepronim vetëm.

Në të njëjtën mënyrë që rrjetet e marrdhënive janë vitale për individët, ato janë të rëndësishme edhe për organizatat. Fatmirësisht, pavarësisht ku ndodhet shkolla juaj, ka gjithmonë njerëz në komunitetin tuaj dhe më gjerë, të cilët janë të gatshëm të ndihmojnë shkollën tuaj, të sjellin programe, të ndajnë përvojën dhe të ofrojnë mbështetje. SAC_u mund të marrë drejtimin në kërkimin dhe detajimin e burimeve, krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimeve. Të udhëhequr nga vizioni i shkollës dhe plani i veprimt që është përpunuar, SAC_u është i përcaktuar në ndërtimin e bashkëpunimeve dhe mbështetjeve, që plotësojnë nevojat e shkollës.

Komisioni i Reformës Shkollore

Kryetar

William J. Green

Komisionerët

Feather Houstoun

Farah Jimenez

Sylvia P. Simms



Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Superintendenti i Shkollave

William R. Hite Jr.

Kryetar i Angazhimit të Familjes & Komunitetit

Evelyn Sample-Oates

Menaxher i Programit për Këshillat

Konsultativë të Shkollave

Julia Manokhina

Për më tepër informacion rreth

Këshillave Konsultativë të Shkollës, ju lutemi vizitoni

www.philasd.org/sac, e-mail

sac@philasd.org, ose telefononi 215-400-4180.

Në rast se jeni i interesuar në antarësimin në SAC, ju lutemi plotësoni formularin e Emërimit në SAC online, ose pyetni për një kopje në shkollën tuaj. Në rast se SAC_u juaj aktualisht nuk bën pranime të reja, ju lutemi mësoni rreth takimit të ardhshëm të SAC_ut, dhe merrni pjesë si i ftuar. Ju mund të plotësoni formularin për emërimin tuaj dhe të kërkonit për t'u zgjedhur në vitin e ardhshëm shkollore.



Bëni që Zëri Juaj të Dëgjohej!

Bashkohuni në

{SAC}

Këshillin Konsultativ të Shkollës

SAC =

Vizion
Punë në Grup
Përkushtim
Krijimtari
Resultate

Një mundësi për Përmirësimin e Shkollës Tuaj

www.philasd.org/sac



Çfarë është Këshilli Konsultativ i Shkollës?

Këshilli Konsultativ i Shkollës (SAC) është një organizëm konsultativ që siguron përfaqësimin mbarëshkollor kur diskutohen çështje dhe merren vendime të cilat kanë ndikim në të gjithë shkollën.

SAC_u fton të gjithë njerëzit e interesuar për mbarëvajtjen e shkollës, të ndajnë idetë dhe të mundësojnë që shkolla të bëhet një mjedis më i mirë për të gjithë nxënësit. Duke ofruar një bord kompetent për opinionet dhe pikëpamjet e ndryshme, SAC bëhet platformë e diskutimeve dhe bashkëpunimeve midis antarëve dhe grupeve të interesuara, që ata përfaqësojnë.

SAC_u është gjithashtu një grup i përgjegjshëm për ndërmarrjen e veprimeve dhe arritjen e rezultateve.

Numri i saktë i antarëve të SAC_ut është i ndryshëm në shkolla të ndryshme, por drejtimet e përgjithshme për plotësimin e tyre janë të njëjta. Të gjithë SA_et kanë një total pjestarësh nga 7 deri 21 persona, ku përfshihen:

- Drejtori i Shkollës
- Më së paku 2 pjestarë nga personeli
- Një pjestar i komunitetit (ose pjestarë) , që përfaqësojnë organizatat partnere të shkollës
- Prindërit, të cilët përfaqësojnë shumicën e pjestarëve (51% ose më shumë) të SAC_ut
- Më së paku 3 nxënës në shkollat e mesme (jo e detyrueshme për shkollat fillore dhe tetëvjeçare)

Kur krijohet për herë të parë SAC_u, shkolla juaj duhet të përcaktojë përbërjen e saktë. Me formimin e tij, SAC_u mund të rishikojë përbërjen dhe të marrë vendime për përmirësimet.

Antarët me të drejtë vote të SAC_ut, (me përjashtim të Drejtorit dhe Presidentit që përfaqëson aty ku është Shoqatën Shkollë- Familje) përzgjidhen nëpërmjet një procesi demokratik, për një periudhë dy vjeçare. Ju lutemi vizitoni www.philasd.org/sac për më tepër informacion rreth antarësisë dhe procesit të zgjedhjes në SAC, dhe plotësoni online Formularin e Emërimit (Nomination Form) që të bashkoheni me SAC në shkollën tuaj.

Në mbledhjet e SAC_ut janë të mirëpritur edhe persona të tjerë të interesuar, por të drejtën për marrjen e vendimeve dhe kontrollit të tematikës së



Vizioni

Vizioni ka njëforcë reale, në bërjen bashkë të individëve të ndryshëm, bashkimin e tyre rreth një qëllimi dhe përkushtimi të përbashkët. Ai mundëson krijimtarinë tonë, krijon ndjenjën e drejtimit dhe fuqizon veprimin për arritjen e rezultateve.

Vizioni na ndihmon të përqëndrohemi në përpjekjet tona, na mban të motivuar dhe na lejon të matim progresin, përgjatë rrugës tonë. Vizioni i përbashkët gjithashtu ndihmon në sistemimin e punës dhe ecjen në rrugë të reja duke e mbështetur punën e përbashkët të gjithsecilit, për realizimin e ndryshimeve të dukëshme.

Translation and Interpretation Center (9/2014)

Këshilli Konsultativ i Shkollës është mjete i përsosur për shkrirjen e mendimeve dhe pikëpamjeve të ndryshme në një vizion të vetëm , që ndahet dhe mbështetet nga i gjithë komuniteti i shkollës. I pajisur me një vizion, SAC do të ofrojë një bord të gatshëm dhe një strukturë mbështetëse për veprim, nga marrja e drejtimit në zhvillimin e një plani, në planin e veprimit për përcaktimin e mjeteve të nevojshme, krijimin e aleancave të brendëshme dhe jashtë shkollës dhe ndërtimin e bashkëpunimeve, të cilat mund të ndihmojnë në kthimin e vizionit në realitet.

Nga “Unë” në “Ne”

Që të shërbejë si katalizator për veprim dhe motor që përçon punën, SAC_u e ka të nevojshme të punojë i unifikuar si një ekip. Ndërsa puna në ekip mund të jetë eksituese dhe me kënaqësi, shumë herë kërkohet mjaft punë dhe përpjekje, që ajo të realizohet si punë e ekipore. Meqenëse ne dëshirojmë të kemi një ekip të fuqishëm dhe me përvojë, ne do të kërkojmë nga të gjithë antarët e SAC_ut të përqafojnë Zotimin ndaj Antarësisë të SAC-ut (the SAC Member Commitment), si hap të parë dhe parakusht për bashkimin në SAC.

Zotimi do të na ndihmojë të shprehemi se si do të kalojmë nga identiteti, ideja dhe axhenda personale, në pjesë aktive e ekipit dhe mbështetës i identitetit, ideve axhendës kolektive, që janë një nga pikat kryesore të ndërtimit të një SAC_u efektiv.



SAC Brochure (Albanian)